



M.Z FASHION SHPK

Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2014

INDIVIDUALE

Përmbajtja

1. PASQYRA E SITUATES FINANCIARE	1
2. PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE	3
3. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE	4
4. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	5
5. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME	6
6. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE	6
7. GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME	6
8. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL	7
9. AKTIVET AFATSHKURTRA	
9.1. AKTIVET MONETARE (Likuiditete në arkë dhe bankë) (Shenim 1).	12
9.2. LLOGARI KERKESA TE ARKETUESME (Shenimi 2)	12
9.3. LLOGARI KERKESA TE TJERA TE ARKETUESME (Shenimi 3)	13
9.4. INVENTARI I IMET (Shenimi 4).....	13
9.5. INVENTARE MALLRA PER RISHITJE (Shenimi 5)	13
9.6. PARAPAGIME DHE SHPENZIME TE SHTYRA (Shenimi 6).....	13
10. AKTIVE AFATGJATA	
10.1 . MAKINERI DHE PAISJE (Shenimi 7, 8).....	14
11. PASIVET AFATSHKURTRA	
11.1. HUAMARRJET DHE OBLIGACIONET AFATSHKURTA (Shenimi 9)	14
11.2. TE PAGUESHME NDAJ FURNITOREVE (Shenimi 10)	14
11.3. TE PAGUESHME NDAJ PUNONJESVE (Shenimi 11)	16
11.4. DETYRIME TATIMORE (Shenimi 12).....	16
11.5. HUA TE TJERA (Shenimi 13).....	16
12. PASIVET AFATGJATA	
12.1. HUA TE TJERA AFATGJATE (Shenimi 14)	16
13. KAPITALI	
13.1. Kapitali aksionar (Shenimi 15)	17
13.2. Rezerva Ligjore (Shenimi 16)	17
13.3. Rezerva te tjera (Shenimi 17)	17
13.4. Fitim - humbja e vitit financiar (Shenimi 18)	17
14. PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE	
14.1. Shitje Neto (Shenimi 19)	18
14.2. Mallrat e konsumuara (Shenimi 20)	18
14.3. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit (Shenimi 21)	21
14.4. Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit (Shenimi 22, 23).....	21
14.5. Amortizimi per Aktive Afatgjata Materiale (shenimi 24)	22
14.6. Te ardhura dhe shpenzime per interesa (Shenimi 25)	22
14.7. Te ardhura dhe shpenzime nga Kurset e kembimit (Shenimi 26)	22
14.8. Fitimi – humbja para tatimit (Shenimi 27)	23

M. Z FASHION SHPK**Pasqyra financiare per vitin ushtrimor 2014**

(Vlerat ne ALL)

1. PASQYRA E SITUATES FINANCIARE

A	AKTIVET	Shenime	Viti Ushtrimor 2014	Viti Paraardhës 2013
I	Aktivët Afatshkurtra			
1	Mjete monetare	1	40,390,823	21,591,691
2	Dervativë dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim		-	-
a)	Derivatvët			
b)	Aktivët e mbajtura për tregtim			
	Totali		40,390,823	21,591,691
3	Aktive të tjera financiare afatshkurtra		191,429,386	55,731,490
a)	Llogari / Kërkesa te arkëtueshme	2	173,066,692	10,494,855
b)	Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	3	18,362,694	45,236,635
c)	Instrumente të tjera borxhi		-	-
d)	Investime të tjera financiare		-	-
	Totali		191,429,386	55,731,490
4	Inventari		499,966,823	309,601,187
a)	Lëndët e para (inventar i imet)	4	13,544,517	12,815,758
b)	Prodhim në proces		-	-
c)	Produkte të gatshme		-	-
d)	Mallra per rishitje	5	486,422,306	296,785,429
e)	Parapagesa për furnizime		-	-
	Totali		499,966,823	309,601,187
5	Aktivët biologjike afatshkurtra			
6	Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje			
7	Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	6	14,334,525	14,334,525
	AKTIVET TOTALE AFATSHKURTRA		746,121,557	401,258,893
II	Aktivët Afatgjata			
1	Investimet financiare afatgjata		-	-
a)	Aksione dhe pjesmarrje të tjera në njësi te kontrolluara (vetëm për pasqyrat financiare të pakonsoliduara)			
b)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje			
c)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë			
d)	Llogari / Kërkesa te arkëtueshme afatgjata			
	Totali		-	-
2	Aktive afatgjata materiale		402,635,638	115,632,519
a)	Toka			
b)	Ndertesa (minus amortizimi)			
c)	Makineri dhe paisje (minus amortizimi)	7	358,757,594	91,603,679
d)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vlere kontabel te mbetur)	8	43,878,044	24,028,840
	Totali		402,635,638	115,632,519
3	Aktive biologjike afatgjata			
4	Aktivët afatgjata jomateriale		-	-
a)	Emri i mirë			
b)	Shpenzimet e zhvillimit		-	-
c)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale		-	-
	Totali		-	-
5	Kapitali aksionar i papaguar			
6	Aktive të tjera afatgjata (në proces)			
	TOTALI AKTIVEVE AFATGJATA		402,635,638	115,632,519
	TOTALI AKTIVEVE		1,148,757,195	516,891,412 ¹

¹ Pasqyra e Situates Financiare duhet te lexohet bashke me shpjeguese nga numri 8 deri 20 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

M. Z FASHION SHPK
Pasqyra financiare per vitin ushtrimor 2014
(Vlerat ne ALL)

B	PASIVET DHE KAPITALI	Shenime	Viti Ushtrimor 2014	Viti Paraardhës 2013
I	Pasivet Afatshkurtra			
1	Dervativët			
2	Huamarrjet		104,404,489	57,502,500
a)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra	9	104,404,489	57,502,500
b)	Kthimet / ripagesat e huave afatgjata		-	
c)	Bono të konvertueshme		-	-
	Totali		104,404,489	57,502,500
3	Huat dhe parapagimet		881,764,502	325,920,466
a)	Te pagueshme ndaj furnitorëve	10	873,270,630	322,591,993
b)	Te pagueshme ndaj punonjësve	11	-	100,460
c)	Detyrimet tatimore	12	1,257,117	705,385
d)	Hua të tjera	13	7,236,755	2,522,628
e)	Parapagimet e arkëtuara		-	-
	Totali		881,764,502	325,920,466
4	Grandet dhe të ardhurat e shtyra			
5	Provizionet afatshkurtra		-	-
	TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA		986,168,991	383,422,966
II	Pasivet Afatgjata			
1	Huat afatgjata		-	-
a)	Hua , bono dhe detyrime nga qeraja financiare		-	-
b)	Bonot e konvertueshme		-	-
	Totali		-	-
2	Huamarrje të tjera afatgjata	14	108,534,859	39,663,682
3	Provizionet afatgjata			
4	Grandet dhe të ardhurat të shtyra			
	TOTALI I PASIVEVE AFATGJATA		108,534,859	39,663,682
	TOTALI I PASIVEVE		1,094,703,850	423,086,648
III	Kapitali			
1	Aksionet e pakicës (vetem per pasq.fin.të konsoliduara)		-	-
2	Kapitali që i përket aksionerëve të shoqërise mëmë (përdoret vetem per pasq.fin.të konsoliduara)		-	-
3	Kapitali aksionar	15	86,600,000	86,600,000
4	Primi i aksionit		-	-
5	Njësité ose aksionet e thesarit (negative)		-	-
6	Rezerva statusore			-
7	Rezerva ligjore	16	372,170	372,170
8	Rezerva të tjera	17	20,734,422	20,734,422
9	Fitimet e pashpërndara		(13,901,828)	-
10	Fitimi (humbja) e vitit financiar	18	(39,751,419)	(13,901,828)
	TOTALI I KAPITALIT		54,053,345	93,804,764
	TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT		1,148,757,195	516,891,412²

² Pasqyra e Situates Financiare duhet te lexohet bashke me shpjeguese nga numri 8 deri 20 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

2. PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

N.r.	P Ë R S H K R I M I	Shenime	Viti Ushtrimor 2014	Viti Paraardhës 2013
1	Shitjet neto	19	813,707,292	519,865,170
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë shfrytëzimit			
3	Ndryshimet në inventarin e p.gatshme dhe p. proces		-	-
4	Puna e kryer nga njësia ekonomike raportuese për qëllimet e veta dhe e kapitalizuar		-	-
5	Mallra , lëndët e para dhe shërbimet	20	(621,929,044)	(378,028,022)
6	Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	21	(137,450,107)	(88,203,132)
7	Shpenzime të personelit		(51,749,706)	(32,960,299)
a)	Pagat	22	(44,610,681)	(28,487,043)
b)	Shpenzimet e sigurimeve shoqërore	23	(7,139,025)	(4,473,256)
c)	Shpenzimet për pensionet		-	-
8	Rënia në vlerë (zhvlerësimi) dhe amortizimi	24	(27,101,441)	(26,409,453)
	Fitimi (humbja) nga veprimtaritë e shfrytëzimit		(24,523,006)	(5,735,736)
1	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitet e kontrolluara			
2	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet			
3	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		(15,228,413)	(10,344,553)
a)	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata		-	-
b)	Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi	25	(14,467,434)	(8,930,398)
c)	Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimit	26	(760,979)	(1,414,155)
d)	Të ardhurat dhe shpenzime të tjera financiare		-	-
	Fitimi (humbja) para tatimit	27	(39,751,419)	(16,080,289)
	Aktiv Tatimor i shtyre			2,178,461
	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin 15 % (10%)		-	-
	Fitimi (humbja) neto e vitit financiar		(39,751,419)	(13,901,828)³

Ledia TELHAI

Administratori



Tiranë më 20.Mars 2015

Haki KURTI

Drejtori i Financës



"M. Z. Fashion" sh.p.k.
Tirana - Albania

³ Pasqyra e te ardhurave gjithëpërshirëse duhet të lexohet bashkë me shpjeguese nga numri 8 deri 20 që janë pjesë perberese e pasqyrave financiare

M. Z FASHION SHPK
Pasqyra financiare per vitin ushtrimor 2014
(Vlerat ne ALL)

PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE⁴

N.r.	P Ë R S H K R I M I	Shenime	Viti Ushtrimor 2014	Viti Paraardhës 2013
A	Fluksi parave nga veprimtarite e shfrytezimit			
1	Paratë e arkëtuara nga klientët		812,938,837	623,724,767
2	Paratë e paguara ndaj furnitorëve dhe punonjësve		(671,264,450)	(672,634,812)
3	Paratë e ardhura nga veprimtaritë		-	-
4	Interesi i paguar		(14,468,144)	(8,930,398)
5	Tatim fitimi i paguar		(192,895)	(495,464)
	Paraja neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		127,013,348	(58,335,907)
B	Fluksi i parave nga veprimtarite e investuese			
1	Blerja e kompanise se kontrolluar X së kontrolluar minus paratë e arkëtuara		-	-
2	Blerja e aktiveve afatgjata		(314,104,560)	(75,848)
3	Të ardhura nga shitja e aktiveve afatgjate		-	-
4	Interesi i arkëtuar		710	-
5	Dividendët e arkëtuar		-	-
	Paraja neto, e përdorur në aktivitetet investuese		(314,103,850)	(75,848)
C	Fluksi i parave nga aktivitetet financiare			
1	Te ardhura nga emetimi i kapitalit aksionar		205,889,634	55,445,222
2	Te ardhura nga huamarrje afatgjata		-	-
3	Pagesat e detyrimeve të qirasë financiare		-	-
4	Dividendë të paguar		-	-
	Para neto e përdorur në veprimtaritë financiare		205,889,634	55,445,222
	Rritja / (rënia) neto e mjeteve monetare		18,799,132	(2,966,533)
	Mjete monetare ne fillim te periudhes kontabel		21,591,691	24,558,224
	Mjete monetare ne fund te periudhes kontabel		40,390,823	21,591,691

“M. Z. Fashion” sh.p.k.
Tirana - Albania

⁴ Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare është përgatitur sipas metodës indirekte.

M. Z FASHION SHPK

Pasqyrat Financiare per vitin ushtrimor 2014

(Vlerat ne ALL)

4. PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione të thesant	Rezerva statusore dhe ligjore	Fitimi i pashpërndarë	Totali i Kapitaleve të veta
Pozicioni më 31 Dhjetor 2012	86,600,000	-	-	17,634,457	3,472,135	107,706,592
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(13,901,828)	(13,901,828)
Dividendët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës kapitalit	-	-	-	3,472,135	(3,472,135)	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2013	86,600,000	-	-	21,106,592	(13,901,828)	93,804,764
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(39,751,419)	(39,751,419)
Dividendët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve	-	-	-	-	-	-
Pozicioni më 31 Dhjetor 2014	86,600,000	-	-	21,106,592	(53,653,247)	54,053,345

"M. Z. Fashion" sh.p.k.
Tirana - Albania

5. INFORMACIONE TE PERGJITHESHME

Shoqëria **M.Z Fashion Shpk** është krijuar me datë 23 Qershor 2005 me Vendim të Gjykatës së Shkalles Pare Tirane Nr. 33742 dhe është regjistruar në regjistrin e shoqërive tregtare në të njëjtën ditë, me kapital të nënshkruar prej 100.000 leke, me ortakë të vetëm "Balfin 'shpk me kapital të nënshkruar prej **86'600'000 leke** dhe administrator Znj.Ledia TELHAI.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është; tregtimi i mallrave me shumicë e pakice, Import-Eksport, etj, sipas objektit të veprimtarisë të përcaktuar në vendimin e gjykatës Tirane.

Vendi i ushtrimit të aktivitetit të kësaj shoqërie është në Qendren Tregtare Univers (QTU), Tirana East Gate (TEG) dhe Tirane. M.Z.Fashion zoteron keto njësi tregtimi sic vijojne : Golden Point QTU, Geox QTU, Mango TEG, Mango QTU, Springfield TEG, Okaidi QTU, Okaidi TEG, Terranova QTU, Terranova TEG, Prenatal TEG, Carpisa TEG, Calliope QTU, Springfield QTU, Golden Point Tirane , Okaidi Tirane , Golden Point TEG, Geox TEG.

6. BAZA E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE

Shoqëria i mban të dhënat e kontabilitetit dhe publikon pasqyrat e saj financiare të vitit 20XX në bazë të Standardeve Kombëtare të Raportimit Financiar ("SKK"), të shpallura me Urdhërin e Ministrit të Financave Nr. 4292 datë 15.06.2006 dhe në përputhje me Ligjin mbi kontabilitetin no: 9228 datë 29 Prill 2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar.

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në Lek shqiptar ("Lekë"), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik, ku operon Shoqëria. Shifrat janë të rrumbullakosura në Lekë.

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuara dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t'i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përputhje për t'i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Shoqërisë.

7. GJYKIMET, VLERESIMET DHE SUPOZIMET KONTABEL TE RENDESISHME

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKK kërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacioni mbi elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë paraqitur më poshtë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël të adoptura nga Shoqëria të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënimet specifike të aktiveve ose detyrimeve.

Tatimi mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Shoqëria njeh detyrimet për çështjet e parashikuara tatimore të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimin aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë

8. POLITIKA TE RENDESISHME KONTABEL

(a) Transaksionet në monedhë të huaj

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon shoqëria.

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit që është kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2014 është 1 Euro me 140.14 Lekë.

Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monedhë të huaj.

(b) Instrumentat financiarë

Shoqëria fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Shoqëria ç'rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivitetit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga shoqëria paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur shoqëria ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiar jo derivativë të shoqërisë përfshijnë të drejta të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare, si dhe depozitat afatshkurtra me një maturitet tre mujor ose më pak. Për qëllime të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre perbehen nga paraja dhe depozitat afatshkurtra të percaktuara me lart, pasi i zbritet teprica e paradhënies bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi

Huamarrjet dhe parapagimet

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

Llogaritëe pagueshme

Llogaritëe pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit

M. Z FASHION SHPK
Pasqyra financiare per vitin ushtrimor 2014
(Vlerat ne ALL)

Te tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interes efektiv, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet. *Kapitali aksionar*

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

(c) Aktivet Afatgjata investimi

Aktive afatgjata investimi, të cilat janë prona të mbajtura për të fituar të ardhura nga qeratë dhe / ose për rivlerësimin e kapitalit (duke përfshirë prona në ndërtim për qëllime të tilla), maten fillimisht me kosto, duke përfshirë koston e transaksionit. Ato njihen fillimisht në pasqyrën e pozicionit financiar në momentin që rreziqet dhe përfitimet nga pronësia transferohen te shoqëria pavarësisht nga fakti nëse titulli është transferuar apo jo. Ato maten fillimisht me kosto. Pas momentit të njohjes, në vijim aktivet afatgjata investimi maten me modelin e koston. Aktivet afatgjata investimi, të cilat janë në proces ndërtimi të lidhura me projekte të reja me të cilat po merrret shoqëria, për ndërtimin e magazinave që do të jepen me qera ku përfshirja e shoqërisë në menaxhimin do të jetë minimale. Si e tillë, shoqëria po llogarit kostot direkte të ndodhura gjatë procesit të ndërtimit dhe sjelljes së aktivit në kushtet për tu dhënë me qera.

(d) Aktive afatgjata material

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parashë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve afatgjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivit afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot ne vijim

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivit afatgjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivit në rast së është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërruara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivit ose çdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet ne pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur sipas normave të mëposhtme për secilën kategori asetesh:

a) Ndërtesa	5 %
b) Instalime Teknike	10%
c) Moblije dhe Paisje zyre	20%
d) Pajisje informatike	25%

Kjo mënyrë pasqyron më përafërsis trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Aktivitet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.



(e) Aktive afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar.

Kostot ne vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivi specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës, njihen në pasqyrën e të ardhurave përmblendhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur.

(f) Zhvlerësimi

Aktivitet financiare

Një aktiv financiar që nuk mbahet me vlerën e drejtë, vlerësohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna objektive që ka pësuar rënie në vlerë. Një aktiv financiar bie në vlerë nëse ka të dhëna objektive të një ngjarje që ka çuar në rënie e vlerës së tij pas momentit fillestar të njohjes së aktivitet, dhe kjo ngjarje ka efekt negativ në vlerësimin e flukseve të ardhshme nga aktivi të cilat mund të maten me besueshmëri.

Humbja nga rënia në vlerë e aktivitet të vlerësuar me koston e amortizuar llogaritet si diferencë midis vlerës kontabël dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme që priten të gjenerohen nga ky aktiv financiar të aktualizuara me normën fillestare efektive të interesit. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave përmblendhëse (në humbje ose fitim) në një llogari zbritje kundër të arkëtueshmet. Interesi nga aktivitet e zhvlerësuar në këtë mënyrë vazhdon të njihet nëpërmjet amortizimit të skontos. Kur një ngjarje pasuese shkakton zvogëlimin e rënies në vlerë, shuma përkatëse rimerret nëpërmjet pasqyrës përmblendhëse të të ardhurave, fitimit ose humbjeve.

Aktivitet jo financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo financiare të shoqërisë rishikohet në datën e raportimit për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dhënë për rënie në vlerë. Nëse ekziston ndonjë evidence e tillë atëherë matet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Vlera e rikuperueshme është vlera më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Gjatë vlerësimit të vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar skontohen në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit, e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parës dhe risqeve specifike të aktiveve që nuk janë marrë parasysh në vlerësimin e flukseve të ardhshme. Humbje nga rënia e vlerës njihet nëse vlera kontabël e aktivitet ose e njësive të tij të gjenerimit të parës tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

(g) Perfitimet e punonjesve

Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Gjatë ecursisë normale të biznesit, Shoqëria bën pagesa në emër të saj dhe të punonjësve për kontributet shoqërore dhe shëndetësore, të cilat janë të detyrueshme bazuar në legjislacion. Këto kosto të kryera në emër të shoqërisë, janë të paraqitura në pasqyrën përmblendhëse të të ardhurave dhe shpenziemve në momentin e ndodhjes.

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, gjatë aktivitetit të saj, bën pagesa në emër të saj dhe në emër të punonjësve për të kontribuar në planin e pensionit sipas legjislacionit lokal. Kostot që ndodhin për këto plane i takojnë shoqërisë dhe ngarkohen në fitimin ose humbjen brenda vitit ushtrimor.



Leja e zakonshme e paguar

Shoqeria njeh si detyrim shumat e paskontuara të kostove të lidhura me lejen vjetore e cila pritët të paguhet në shkëmbim të shërbimit të ofruar nga punonjësi për periudhën.

(h) Provigjonet

Provigjoni njihet kur, si pasojë e ngjarjeve të kaluara, shoqëria ka detyrime aktuale ligjore apo konstruktive të cilat mund të vlerësohen me vërtetësi, dhe ka mundësi që të ketë nxjerrje të flukseve të ardhshme të parasë për të shlyer këtë detyrim. Provigjonet përcaktohen nga aktualizimi i flukseve të pritshme me një normë para tatimi që reflekton vlerësimet aktuale të tregut të parasë dhe rrezikut specifik të detyrimeve.

(i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë flukset bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës të cilat gjenerohen përgjatë ecurisë normale të aktiviteteve të biznesit.

(j) Të ardhurat nga shitja

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve.

Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet të ofruara.

(k) Pagesat per qeranë financiare

Qeratë klasifikohen si qera financiare kur kushtet e qerasë transferojnë në menyrë domethënëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qeramarrësi. Të gjitha qeratë e tjera klasifikohen si qera operative. Pagesat e bëra për qeranë operative janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës

Depozitimet e qeramarrësit

Detyrimet e depozitimeve të qeramarrësit fillimisht njihen me vlerë të drejtë dhe maten me kosto të amortizueshme kur është materiale. Diferencat ndërmjet vlerës fillestare të drejtë dhe shumës nominale përfshihet si një komponent i të ardhurave nga kontrata e qerasë dhe njihen në bazë lineare përgjatë kohëzgjatjes së kontratës.

(l) Te ardhurat financiare dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përbëhen nga të ardhurat nga interesi për fondet e investuara në depozita bankare dhe nga të ardhurat nga kursi i këmbimi.

Kostot financiare përbëhen nga shpenzimet e interesit të huave, shpenzime nga kurset e këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare në fitim dhe humbje nga rënia në vlerë e aktiveve financiare.

Humbjet apo fitimet nga kursi i këmbimit janë paraqitur në vlerë neto.

(m) Kostot e huamarrjes

Kostot e huave të lidhura direkt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve, të cilat duan një kohë të gjatë për t'u sjellë në formë përfundimtare, në mënyrë që të përdoren apo shiten, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, deri në momentin kur këto aktive janë gati për qëllimin e tyre për përdorim ose për shitje.

Të ardhurat nga investimet e përkohshme, për sa i përket disa huave të veçanta, të cilave ende nuk ju është paguar interesi, kjo shumë ju zbritet kostove të huamarrjes dhe nuk i kapitalizohet koston e aktivitetit.

Të gjitha kostot e tjera njihen si të ardhura ose shpenzime në periudhën kur ato kanë ndodhur.

(n) Taksat

Tatimi mbi fitimin nënkupton tatimin e periudhës dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në të ardhura ose shpenzime përveç rasteve kur lidhen me zera të njohur direkt në kapital, në të cilat regjistrohen direkt në kapital.

Tatimi i periudhës është tatimi i pritshëm, i pagueshëm mbi fitimin e tatueshem për vitin, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo sistemim mbi tatimin e pagueshëm të lidhur me vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë njihet duke përdorur metodën e bilancit, duke paraqitur për diferencat e përkohshme midis vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që priten të aplikohen për diferencat e përkohshme kur ato të kthehen, bazuar në ligjet që kanë hyrë ose do të hyjnë në fuqi deri në datën e raportimit.

Një aktiv i tatimit të shtyrë njihet nëse është e mundshme që të ardhurat e ardhshme të tatueshme do të realizohen kundrejt të cilave diferencat e përkohshme mund të përdoren. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri sa nuk janë më të mundshme që përfitimet tatimore të lidhura me të do të realizohen.

(o) Ngjarjet pas datës së bilancit

Ngjarjet pas datës së raportimit, të cilat ofrojnë dëshmi për kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit, trajtohen si ngjarje të korrigjueshme në këto pasqyra financiare. Ata që janë tregues të kushteve që lindin pas datës së raportimit janë trajtuar si ngjarje të pakorrigjueshme.



9. AKTIVET AFATSHKURTRA

9.1. Aktive monetare (likuiditete në arkë dhe bankë), shënimi 1

Gjëndjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në lekë dhe në valutë, në datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

Vlera Monetare	31 Dhjetor 2014			31 Dhjetor 2013		
	Euro	Lekë	Kursi	Euro	Lekë	Kursi
Banka Eur	22,418	3,141,915	140.14	62,405	8,748,957	140.20
Banka All		36,949,652			11,652,371	
Arka Eur		-	140.14		-	140.20
Arka All		299,256			1,190,363	
Totali		40,390,823			21,591,691	

9.2. (3.a.)Llogari kërkesa të arkëtueshme , shënimi 2

Eshtë gjëndja e klientëve nga shitja e mallrave të cilët do të arketohen gjatë periudhës ushtrimore të ardhshme. Gjëndja e klientëve në datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

Klientë	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Delta Publicity	5,398,605	5,398,605
Raiffeisen Bank	20,900	-
Vizion Plus	-	534,541
Tirana Bank	28,000	-
Mane TCI	32,124,695	-
Shitje me kase	1,323,990	2,475,477
Media 6	-	268,145
Kid Zone	133,957,447	-
Tirana East Gate	188,754	403,471
Lamitrans Albania	-	2,792
MFI shpk	-	1,264,500
United Nations Albania	24,300	-
Orbico	-	147,324
Totali	173,066,692	10,494,855

9.3. (3.b.)Llogari kërkesa të tjera arketueshme , shënimi 3

Në këtë post janë paraqitur kërkesa të tjera të arkëtueshme , analiza si më poshtë :

Kerkesa te arketueshme	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Tatim mbi vlerën e shtuar mbipaguar	17,817,381	27,636,793
Tatim mbi fitimin i parapaguar	192,895	533,087
Parapagime	162,123	16,552,491
Debitore të tjerë	190,295	190,295
Takse doganore mbipagesë	-	4,770
Ortakut	-	319,199
Totali	18,362,694	45,236,635

9.4. (4.a.)Inventarë (inventari i imet) , shënimi 4

Në këtë post është paraqitur gjëndja e inventarit të imët që shoqëria, disponon në fund të periudhës ushtrimore .

Inventare	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<i>Inventar i imet</i>	<i>12,689,517</i>	<i>10,114,162</i>
<i>Ambalazhe</i>	<i>855,000</i>	<i>2,701,595</i>
Totali	13,544,517	12,815,757

9.5. (4.b.)Inventare mallra per rishitje , shenimi 5

Në këtë post është paraqitur gjëndja e inventarit të mallrave, i cili është llogaritur me koston e blerjes në fillim dhe në vijimesi me koston mesatare të ponderuar. Gjëndja e inventarit të mallrave më datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

Inventarë mallra per rishitje	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<i>Mallra per rishitje per femra</i>	<i>244,394,730</i>	<i>169,167,695</i>
<i>Mallra per rishitje per meshkuj</i>	<i>83,889,809</i>	<i>47,485,669</i>
<i>Mallra per rishitje per femije</i>	<i>110,217,231</i>	<i>56,389,232</i>
<i>Mallra per rishitje aksesore</i>	<i>47,920,535</i>	<i>23,742,834</i>
Totali	486,422,306	296,785,429

9.6. Parapagime dhe shpenzime të shtyra , shënimi 6

Parapagime dhe shpenzime të shtyra në fund të vitit ushtrimor paraqiten në vlerën 14,334,525 lekë.

Parapagime dhe shpenzime te shtyra	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2012
<i>Parapagime dhe shpenzime te shtyra</i>	<i>14,334,525</i>	<i>14,334,525</i>
Totali	14,334,525	14,334,525

10 AKTIVET AFATGJATA

10.1. Makineri dhe paisje , shënimi 7, 8

Vlerësimi i Aktiveve Afatgjata Materiale në bilanc është bërë me koston minus amortizimin e akumuluar.
Në këtë post janë paraqitur asetet , vlerësimi i tyre në bilanc është bërë në bazë të S.K.K.5

Aktive Afatgjata	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Makineri , paisje , instalime	42,148,230	24,028,840
Mobilje dhe paisje zyre	288,108,608	81,551,237
Paisje informatike	59,599,971	10,052,442
Te tjera	12,778,829	-
Totali	402,635,638	115,632,519

11 .PASIVET AFATSHKURTRA

11.1 - (2)Huamarrjet dhe obligacionet afatshkurtra , shënimi 9

Në këtë post janë paraqitur huatë afatshkurtra qe shoqëria ka ndaj bankes (ovedraftet).

Huamarrjet dhe obligacionet afatshkurtra	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Hua afatshkurtra (ovedrafte)	104,404,489	57,502,500
Totali	104,404,489	57,502,500

11.2 (3.a) Të pagueshme ndaj furnitorëve , shënimi 10

Në këtë post janë paraqitur detyrimi që ka shoqëria ndaj të tretëve , të cilat priten të likujdohen gjatë periudhës së ardhshme. Gjëndja e furnitorëve në datat 31 Dhjetor 2014 dhe 31 Dhjetor 2013 janë si më poshtë:

Detyrime ndaj Furnitorve	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
I UP Sh.p.k	409,727	409,727
A E Distribution Sh.p.k	91,000	-
Agim Zeqo	2,458,964	-
AK Retailing	1,131,364	-
Alba All	3,500	-
Alba Eletrica	24,787	12,400,949
Alba Trade	5,619,751	-
Albania Fashion Group	457,094,476	-
Albtours D shpk	484,939	302,076
Anabel Sh.p.k	-	76,857
Balfin shpk	106,433	106,433
Barata & Ramilo	1,946,196	-
CMB Albania	27,364	-
DHL International	10,366	4,800
Digital Signage Advertising	33,601	-
Dixhi Print Al Sh.p.k	450,903	213,429
Elektro Servis Sh.p.k	4,000	-
Enkele Idrizi	1,284,924	-
Entenal SH.P.K	-	35,008

M. Z FASHION SHPK
Pasqyra financiare per vitin ushtrimor 2014
(Vlerat ne ALL)

<i>Eurofiel Confeccion</i>	36,479,983	28,523,255
<i>Eva Blushi</i>	10,000	-
<i>Geox Spa</i>	3,275,726	9,309,799
<i>Global Net</i>	12,597	-
<i>Golden Lady</i>	16,263,237	13,309,523
<i>I Tirana sh.p.k</i>	-	43,740
<i>Ikub Info Business Advisory</i>	27,928	-
<i>Infosoft Office sha</i>	168,143	-
<i>Infosoft SD</i>	172,371	-
<i>Insig sha</i>	684	-
<i>Kastrati</i>	8,806	-
<i>Kuhne Nagel</i>	371,971	608,443
<i>Kuvera</i>	10,406,417	10,296,266
<i>Lajthiza Invest sha</i>	28,350	-
<i>Lamitrans Albania sh.a</i>	-	80,692
<i>Lamitrans Custom Service shpk</i>	39,345	-
<i>Mandia Print shpk</i>	102,578	33,632
<i>Mane TCI</i>	188,513	-
<i>Mango Punto Fa</i>	222,006,153	198,186,459
<i>Metro shpk</i>	140,044	-
<i>Myslym Qarri</i>	67,500	-
<i>Neptun shpk</i>	289,117	-
<i>Okaidi</i>	44,377,049	47,809,999
<i>Onufri Sh.p.k</i>	27,600	22,080
<i>Pastor Force S.A</i>	38,640	-
<i>Pazar shpk</i>	21,217,350	-
<i>Platea Sh.a</i>	140,540	281,030
<i>Porcelanoza</i>	321,899	-
<i>Prenatal SPA</i>	9,347,655	-
<i>Prespa Invest Shpk</i>	139,890	-
<i>Print Store Albania Sh.p.k</i>	67,380	-
<i>Prnit Store Albania sh.p.k</i>	-	87,384
<i>Proton Shpk</i>	111,328	-
<i>Teddy</i>	35,705,278	-
<i>Tenzor sh.p.k</i>	50,507	66,054
<i>Tirana East Gate</i>	464,612	231,540
<i>Top Albania sha</i>	19,143	152,818
	873,270,630	322,591,993

11.3 (3.b) Të pagueshme ndaj punonjësve, shënimi 11

Në këtë post janë paraqitur detyrimet që shoqëria ka për punonjësit për përfitimet afatshkurtra, më 31 Dhjetor 2014 shoqëria nuk ka detyrime ndaj punonjësve.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Të pagueshme ndaj punonjësve		
<i>Të pagueshme ndaj punonjësve</i>	-	100,460
Totali	-	100,460

11.4 (3.c) Detyrime tatimore, shënimi 12

Në këtë post janë pasqyruar detyrime tatimore: për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe tatim mbi të ardhurat personale.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Detyrime tatimore		
<i>Sigurime shoqërore dhe shënd.</i>	1,135,814	623,937
<i>Tatim mbi të ardhurat personale</i>	121,303	81,448
Totali	1,257,117	705,385

11.5 (3.d) Hua te tjera, shënimi 13.

Në këtë post janë paraqitur huatë që shoqëria ka ndaj të tretëve .

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Hua te tjera		
<i>Hua nga Albania Fashion Group sh.p.k</i>	668,991	2,522,628
<i>Hua te tjera Ortaku</i>	6,567,764	-
Totali	7,236,755	2,522,628

12. PASIVET AFATGJATA

12.1 Hua të tjera , shënimi 14

Në këtë post paraqiten detyrimet e shoqërisë të cilat sipas SKK3, klasifikohen detyrime afatgjata që shoqëria ka ndaj bankës.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Hua te tjera afatgjata		
<i>Hua afatgjata(Raiffeisen Bank)</i>	69,645,006	39,663,682
<i>Hua afatgjata (BKT)</i>	38,889,853	-
Totali	108,534,859	39,663,682

13. KAPITALI

13.1. Kapitali aksionar , shënimi 15

Në këtë post paraqitet kapitali me vlerë nominale i kontribuar (i paguar ``101`` dhe i nënshkruar i papaguar ``102``) nga aksionerët /ortakë .

Kapitali Aksionar	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<i>Kapitali</i>	<i>86,600,000</i>	<i>86,600,000</i>
Totali	86,600,000	86,600,000

13.2. Rezerva ligjore , shënimi 16

Në këtë post paraqiten rezervimet e detyrueshme kontabël (-1071-) nga fitimi i bazuar në kërkesat e ligjit `` Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare .

Rezerva ligjore	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<i>Rezerva ligjore</i>	<i>372,170</i>	<i>372,170</i>
Totali	372,170	372,170

13.3. Rezerva të tjera, shënime 17

Në këtë post jane paraqitur rezervimet e detyrueshme kontabël (-1078-) nga fitimi që nuk janë të detyrueshme nga kërkesat statutores apo kërkesat e ligjeve të caktuara. Në këtë post paraqiten : fond për garantim page , rezervat për investime etj. , të ardhurat dhe shpenzimet e parealizuar që sipas SKK nuk përfshihen në rezultatin e periudhës , plusvlerat e parealizuar të rivleresimit (- 106-) te AAM dhe AAJM , rezervat që lindin nga diferencat e kurseve të këmbimit gjatë konsolidimit të shoqërive të huaja dhe gjatë ndërtimit të Pasqyrave Financiare të konsoliduara .Gjatë vitit ushtrimor nuk kemi rritje të tyre.

Rezerva te tjera	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<i>Rezerva te tjera</i>	<i>20,734,422</i>	<i>20,734,422</i>
Totali	20,734,422	20,734,422

13.4. Fitim(humbjet) e vitit financiar, shënime 18

Në këtë post paraqiten fitim/humbja e vitit ashtu sic rezulton në pasqyren e situates financiare.

Fitimi i vitit financiar	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
<i>Fitimi/humbja e vitit financiar</i>	<i>(39,751,419)</i>	<i>(13,901,828)</i>
Totali	(39,751,419)	(13,901,828)

14. PASQYRA E TE ARDHURAVE GJITHEPERFSHIRESE

Parimi bazë për përcaktimin e të ardhurave dhe shpenzimeve është parimi i të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Kjo pasqyrë është përpiluar bazuar në klasifikimin e shpenzimeve sipas natyrës së tyre.

14.1. Shitjet neto, shënime 19

Tek rubrika shitjet neto janë pasqyruar të ardhurat nga aktiviteti kryesor i shoqërisë që është në fushën e tregtimit të mallrave.

Shitjet neto	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shitjet neto	813,707,292	519,865,170
Totali	813,707,292	519,865,170

14.2. Mallra të konsumuara , shënime 20

Mallrat e konsumuara gjatë periudhës ushtrimore janë si më poshtë .

Mallra te konsumuara	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Mallrat e konsumuara	603,297,023	362,192,174
Transport	5,195,149	6,146,814
Takse doganore	13,360,777	9,634,581
Akize	76,095	54,453
Totali	621,929,044	378,028,022

14.3. Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit , shënime 21

Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit gjatë periudhës ushtrimore janë si më poshtë.

Përshkrimi	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime per qera	60,127,619	40,281,401
Shpenzime mirmbajtje dhe riparime	2,634,547	544,050
Shpenzime per siguracion	259,145	200,968
Shpenzime konsulence	401,416	204,000
Shpenzime reklame	11,232,143	8,543,785
Shpenzime udhetime dhe dieta	1,164,759	1,144,039
Shpenzime postare dhe telekomunikacion	1,287,109	948,137
Shpenzime per sherbime bankare	12,511,988	7,897,385
Shpenzime noteriale e ligjore	944,067	-
Shpenzime taksa dhe tarifa vendore	373,803	281,120
Shpenzime ambjent i perbashket	18,988,256	11,040,369
Shpenzime te tjera	346,911	3,793,400
Shpenzime per kancelari	1,463,446	874,816
Shpenzime per inventar te imet	22,731,477	7,700,000
Shpenzime energjie elektrike	2,983,421	4,749,662
Totali	137,450,107	88,203,132

14.4. Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytezimit , shënime 22,23.

Kosto e punës për periudhën ushtrimore është si më poshtë.

Pershkrimi	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime page	44,610,681	28,487,043
Shpenzime sig.shoq.shend.	7,139,025	4,473,256
Totali	51,749,706	32,960,299

Numri mesatar I punonjësve të shoqërisë është 123 të punësuar.

	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Staf mbështetës	15	9
Staf operacional	108	69
Totali	123	78

14.5. Amortizimi për Aktive Afagjata Materiale , shënime 24

Në këtë zë janë paraqitur shpenzime për amortizim për AAM-te.

Pershkrimi	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime amortizimi instalime	1,354,362	2,670,830
Shpenzime amortizimi paisje informatike	3,132,744	3,350,814
Shpenzime amortizimi paisje zyre	22,614,335	20,387,809
Totali	27,101,441	26,409,453

14.6. (3.b.) Të ardhura dhe shpenzime për interesa , shënime 25

Këtu janë përfshirë shpenzime për interesa për huatë që shoqëria ka në bankë.

Pershkrimi	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Shpenzime per interesa kredie	8,809,562	4,911,801
Shpenzime per interesa Overdraft	5,657,872	4,018,597
Totali	14,467,434	8,930,398

14.7. (3.c.) Të ardhura dhe shpenzime nga kurset e këmbimit , shënime 26

Këtu janë përfshirë fitim- humbje si efekt i kursit të këmbimit nga monedha e huaj, i cili është përcaktuar në bazë të parimit të kompensimit, sipas kërkesave të standarteve

Pershkrimi	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fitim (humbja) nga kurset e kembimit	(760,979)	(1,414,155)
Totali	(760,979)	(1,414,155)

M. Z FASHION SHPK**Pasqyra financiare per vitin ushtrimor 2014***(Vlerat ne ALL)***14.8 (3.d.) Fitimi – humbja para tatimit , shënime 27**

Këtu është përfshirë fitimi-humbja e shoqërisë për periudhën ushtrimore. Është pasqyruar humbja e vitit ushtrimor në vlerën 39,751,419 lekë , e cila është rregulluar nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal analizuar në tabelën e mëposhtme.

Pershkrimi	31 Dhjetor 2014	31 Dhjetor 2013
Fitimi/humbja para tatimit	(39,751,419)	(16,080,289)
Aktiv Tatimor	-	2,178,461
Tatim Fitimi	-	-
Totali	(39,751,419)	(13,901,828)

